



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

Numri i Ceshtjes : 53805-00086-55-2017      Data e Regjistrimit : 07/02/2017  
Numri i Vendimit: 55-2017-797                      Data e Vendimit : 18/07/2017

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Granit Qypi

SEKRETARE: Lazime Seferi

Sot më datë 18/07/2017 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Akuzuar: FALLSIFIKIM I VULAVE STAMPAVE OSE I FORMULAREVE

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, palët kërkuar:

Prokurori Edmond Kariqi, në diskutimin përfundimtar u shpreh:

Diskutimin e paraqes me shkrim, gjithsej 3(tre) fletë dhe në përfundim gjykatës i kërkoj: Deklarimin fajtor të të pandehurit Basri Elezi, për kryerjen e veprës penale *Fallsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve*, të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal, dhe në bazë të kësaj dispozite të dënohet me 4(katër) muaj burgim.

Në bazë të nenit 59 të Kodit penal të pezullohet dënimi për një periudhë kohore prej 8(tetë) muaj me qëllim që gjatë kësaj kohe prove të mos kryej vepër tjetër penale dhe duhet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës Kukës.

Shpenzimet hetimore proceduriale në masën 16000 lekë sipas faturës bashkëngjitur fashikullit hetimor t'i ngarkohen të pandehurit Basri Elezi."

Avokati Gëzim Gjana, mbrojtës i të pandehurit Basri Elezi i zgjedhur prej tij me deklaram në seancë gjyqësore u shpreh: "Ndëshkimin e të pandehurit Basri Elezi dhe pas caktimit të masës së dënimit aplikimin e nenit 63 të Kodit Penal duke e detyruar këtë të pandehur që të kryejë punë në interes publik"

I Pandehuri Basri Elezi u shpreh: "Kërkoj rrëzimin e kërkesës me burgim dhe jap pëlqimin tim të kryej shërbime publike pa të drejtë pagese".

Gjykata, pasi e analizoi çështjen në tërësi,

VEREN :

Vëren:

Se, nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të shtetasit Basri Elezi në pozicionin "Specialist i Emergjencave në Këshillin e Qarkut Kukës" ka rezultuar se ka fakte për dënim penal me vendim të formës së prerë brenda territorit të RSH, bazuar në shkresën nr 1569/1 datë 04.08.2016 Të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve protokolluar në DAP në datë 05.08.2016. Sipas kësaj shkrese rezulton se z.Basri Elezi rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal pasi është deklaruar fajtor dhe është dënuar me vendimin nr.96 datë 15.09.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit z.Basri Elezi evidentohet se prej tij nuk është deklaruar ky dënim, pasi është përgjigjur "JO" në pyetjen numër 1 "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj"? Bazuar në kreun v, pika 2, shkronja "c" të vendimit nr.17/2016 është përcjellë materiali për verifikim të plotë të deklarimeve të bëra nga shtetasi Basri Elezi në formularin e vetëdeklarimit me të dorëzuar në DAP. Janë administruar nga Këshilli i Qarkut Kukës urdhëri i caktimit në detyrë të shtetasit Basri Elezi në këtë institucion. Nga policia gjyqësore është administruar kopje e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës nr.96 datë 15.09.2000 në të cilën rezulton se ky shtetas është dënuar për veprën penale të parashikuar nga nenet 134 e 186 të Kodit Penal. Në bazë të akt ekspertimit grafik nr.3 datë 31.01.2017 shkrimi i shtetasit Basri Elezi rezulton të jetë shkrimi dhe nënshkrimi i plotësuar të formularit të vetëdeklarimit objekt hetimi pasi është shkruar dhe nënshkruar nga ky shtetas. Nga këto rrethana i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor ka kryer regjistrimin e procedimit penal Nr.399/2016. Në seancë gjyqësore të datës 01.06.2017, **prokurori Edmond Kariqi**, në parashtrimet e tij rreth objektit të kërkesës i qëndroi përmbajtjes së kërkesës që i ka drejtuar gjykatës, e lexoi atë gjithsej 2(dy) fletë dhe si prova, gjykatës i paraqiti:

Urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë 01.09.2016

Shkresë nr.2481/1 datë 30.08.2016

Shkresë nr.4923 prot datë 09.08.2016

Vërtetim i gjendjes gjyqësore nr.11.prot datë 03.08.2016,nr.17 datë 07.10.2016

Formular vetëdeklarimi datë 27.04.2016

Vendim për sekuestrimin e dokumenteve datë 11.01.2017

Procesverbal për sekuestrimin e sendeve datë 20.01.2017

Procesverbal për marrje të modeleve eksperimentale të shkrimit e nënshkrimit të shtetasit Basri Elezi datë 24.11.2016

Vendim për caktim eksperti Tekniko-Grafik datë 23.01.2017

Akt nr.3 datë 31.01.2017

Vendim nr.96 datë 15.09.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Urdhër për emërim në detyrë nr.7/6 prot datë 01.02.2016

Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime datë 27.10.2016

Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, datë 31.01.2017.

Procesverbal për pyetjen e të pandehurit datë 06.02.2017

Procesverbal për njohjen e të pandehurit me aktet datë 06.02.2017

Vendim për dërgimin e çështjes për gjykim datë 06.02.2017

Urdhër për bashkimin e provës materiale datë 06.02.2017

**Avokati Gëzim Gjana u shpreh:** "Pasi prokurori listoi provat shkresore paraqes si si provë vendimin nr.63 datë 15.03.2017 të KQZ-së RSH, vërtetimin e gjendjes gjyqësore nr.11 datë 25.05.2016 si dhe nr.11 datë 07.12.2016 dhe nuk kemi prova të tjera."

**Gjykata**, pasi dëgjoji palët, administroi të gjitha provat shkresore të paraqitura nga ato, si:

Urdhër për regjistrimin e procedimit penal datë 01.09.2016

Shkresë nr.2481/1 datë 30.08.2016

Shkresë nr.4923 prot datë 09.08.2016

Vërtetim i gjendjes gjyqësore nr.11.prot datë 03.08.2016,nr.17 datë 07.10.2016

Formular vetëdeklarimi datë 27.04.2016

Vendim për sekuestrimin e dokumenteve datë 11.01.2017

Procesverbal për sekuestrimin e sendeve datë 20.01.2017

Procesverbal për marrje të modeleve eksperimentale të shkrimit e nënshkrimit të shtetasit Basri Elezi datë 24.11.2016

Vendim për caktim eksperti Tekniko-Grafik datë 23.01.2017

Akt nr.3 datë 31.01.2017

Vendim nr.96 datë 15.09.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Urdhër për emërim në detyrë nr.7/6prot datë 01.02.2016

Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetime datë 27.10.2016

Vendim për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, datë 31.01.2017.

Procesverbal për pyetjen e të pandehurit datë 06.02.2017

Procesverbal për njohjen e të pandehurit me aktet datë 06.02.2017

Vendim për dërgimin e çështjes për gjykim datë 06.02.2017

Urdhër për bashkimin e provës materiale datë 06.02.2017

Vendimin nr.63 datë 15.03.2017 të KQZ-së RSH,

Vërtetimin e gjendjes gjyqësore nr.11 datë 25.05.2016 si dhe nr.11 datë 07.12.2016

Shkresë nr.258/1prot datë 07.06.2017 Të Sektorit të Gjendjes Gjyqësore Tiranë.

**duke i çmuar** ato një nga një dhe në unitet me njëra tjetrën krijon bindjen se, autori i kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal është i pandehuri Basri Elezi ,për këto arsye:

I pandehuri Basri Elezi, me veprimet e tij të kundraligjshme ka plotësuar të dhëna të rreme ,**duke u përgjigjur "JO" në pyetjen numër 1 "A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj"?**,ndërsa në të vërtetë rezulton se ai është dënuar me vendimin nr. nr.96 datë 15.09.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

I pandehuri Basri EleziS ka nënshkruar duke marrë dijeni dhe duke qenë i vetëdijshëm mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit pasi sipas Akt Ekspertimit Tekniko-Grafik nr.3 datë 31.01.2017 nënshkrimi dhe shkrimi i tij në këtë formular janë plotësisht të tij.

I pandehuri është madhor, i përgjegjshëm, për përgjegjësi penale dhe se veprën penale e ka kryer me dashje direkte.

#### Për këto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata, bazuar në nenin 384 dhe 390 të Kodit të Proçedurës Penale

#### VENDOSI:

Vendosi:Deklarimin fajtor të të pandehurit Basri Elezi , i biri i Shanise dhe i Xhevides , dl.01.01.1959 lindur dhe banues në lagjen industriale Bashkia Kukes ,me kombësi e shtetësi shqiptare,me arsim të lartë,për kryerjen e veprës penale "Fallsifikim i vulave,i stampave ose i formularëve", të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite të dënohet me 3(tre)muaj burgim.

Në bazë të nenit 63 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vuajtjes të dënimit për të pandehurin Basri Elezi duke e zëvendësuar këtë pezullim me detyrimin që i pandehuri të përmbushë një punë në interes publik pranë Bashkisë Kukës.

Puna në Interes publik pranë Bashkisë Kukës do të jetë në masën prej 80 (tetedhjetë )orë pune publike dhe do të kryhet brenda 6(gjashtë)muajve nga data që vendimi të marrë formë të prerë.

Urdhërohet i pandehuri Basri Elezi që të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës Kukës.

Shërbimi i Provës Dega Kukës të caktoj llojin e punës,vendin e kryerjes së punës dhe ditët e javës që do të kryhet puna me kohë zgjatje 8(tetë)orë në ditë për të pandehurin Basri Elezi pranë Bashkisë Kukës.

Shpenzimet hetimore proceduriale në masën 2000 lekë t'i ngarkohen të pandehurit Basri Elezi .

Shpenzimet gjyqësore, siç janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim, brenda 10 (dhjetë) ditëve, në Gjykatën e Apelit Shkodër, nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall në Kukës, sot më datë 18.07.2017.

SHPENZIMET GJYQËSORE

Kërkesëpadia

0

Taksa Gjyqësore

0

Noterizime

0

Njoftime

0

Akt ekspertimi

0

Avokat

0

Gjithsej

0

GJYQTAR:

Granit Qypi